



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Byroja

V E N D I M

Nr. 82, datë 02.06.2021

MIRATIMI I RREGULLORES PËR AKREDITIMIN, AKOMODIMIN DHE ORIENTIMIN E MASMEDIEVE PRANË KUVENDIT TË SHQIPERISË


Mbështetur në Regulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, neni 105, pika 4, me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm, Byroja e Kuvendit në mbledhjen e saj të datës 02.06.2021, me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Rregullores për akreditimin, akomodimin dhe orientimin e masmedieve pranë Kuvendit të Shqipërisë” bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Vendimi i Byrosë, nr.4, datë 12.02.2014, për miratimin e “Rregullores për akreditimin, akomodimin dhe orientimin e masmedies pranë Kuvendit të Shqipërisë”, shfuqizohet.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI



RREGULLORE PER AKREDITIMIN, AKOMODIMIN DHE ORIENTIMIN E MASMEDIEVE PRANË KUVENDIT TË SHQIPËRISË

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave për akreditimin, akomodimin dhe orientimin e masmedieve pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për medien audiovizive, medien e shkruar dhe medien elektronike.

Kjo rregullore nuk zbatohet për delegacionet e huaja që vizitojnë Kuvendin e Shqipërisë.

Neni 3

Parimi themelor i veprimtarisë së Kuvendit

Kuvendi i Shqipërisë gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tij udhëhiqet nga parimi i garantimit të së drejtës së informimit dhe transparencës në raport me publikun.

KREU II

MËNYRA E AKREDITIMIT TË MASMEDIEVE

Neni 4

E drejta e akreditimit

Të drejtën e akreditimit e gëzojnë të gjitha mediet audiovizive, të shkruara dhe elektronike, shqiptare dhe të huaja si dhe punonjësit e medias në profesion të lirë.

Neni 5

Kërkesa për akreditim

Akreditimi kryhet në bazë të kërkesës së institucionit mediatik pranë të cilit janë të punësuar personat që do të akreditohen.

Në rastin e punonjësve të medias në profesion të lirë kërkesa paraqitet nga vetë personi.

Neni 6

Personat e akredituar

Akreditimi jepet për:

gazetarë;
fotografë (fotoreporterë);
ekipe xhirimi;
teknike;
operatorë;
regjisorë;
kameramanë;
shoferë.

Neni 7

Kohëzgjatja e akreditimit

Akreditimi pranë Kuvendit të Shqipërisë mund të jetë:

ditor;
javor;
sesional;
vjetor (vit kalendarik);
për të gjithë kohëzgjatjen e legjislaturës.

Neni 8

Dokumentacioni i nevojshëm

1. Institucionet medietike që dëshirojnë të akreditohen pranë Kuvendit të Shqipërisë duhet të paraqesin këto dokumente:
 - a) kërkesën për akreditim ku të përcaktohen personat që përfaqësojnë institucionin mediatik me funksionet përkatëse;
 - b) dokument identifikimi i personave që do të akreditohen;
 - c) fotografi në përmasat 4x3;
 - d) periodha për të cilën kërkohet akreditimi;

2. Punonjësit e medias në profesion të lirë që dëshirojnë të akreditohen pranë Kuvendit të Shqipërisë duhet të paraqesin këto dokumente:
 - a) kërkesën për akreditim;
 - b) kartë të gazetarit të lëshuar nga një shoqatë gazetarësh e njohur ligjërish;
 - c) shkrime personale të botuara;
 - d) fotografi në përmasat 4x3;
 - e) periudha për të cilën kërkohet akreditimi.

Neni 9

Pajisja me kartë akreditimi

1. Dokumentacioni i paraqitur shqyrtohet nga Kuvendi brenda 7 ditëve nga paraqitja.
2. Kuvendi, në rast përmbushje të kriterëve dhe dokumentacionit, pajis personat e akredituar me kartën e akreditimit të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm.
3. Karta e akreditimit kur kërkohet nga institucioni mediatik përmban:
 - emër/mbiemër;
 - institucionin medietik që përfaqëson;
 - periudhën e akreditimit;
 - funksionin që mban personi;
 - fotografi në përmasat 4x3;
 - numrin rendor.
4. Karta e akreditimit për punonjësit e medias në profesion të lirë përmban:
 - emër/mbiemër;
 - periudhën e akreditimit;
 - fotografi në përmasat 4x3;
 - numrin rendor.
5. Personat e akredituar gjatë qëndrimit në Kuvend mbajnë në vend të dukshëm kartën e akreditimit.

Neni 10

Rinovimi i kartës së akreditimit

Karta e akreditimit rinovohet me kërkesë të institucionit medietik ose të vetë punonjësit të medias në profesion të lirë.

KREU III

AKOMODIMI I MASMEDIEVE

Neni 11

Kontrolli në hyrje

Personat e akredituar i nënshtrohen rregullave të kontrollit, të miratuara nga Byroja e Kuvendit, për hyrje-daljen në mjediset e Kuvendit.

Neni 12

Akomodimi

Personat e akredituar pranë Kuvendit të Shqipërisë akomodohen në dy godinat e parlamentit, në mjediset e caktuara për ta si me poshtë:

1. Te Kryesia e Kuvendit në Neës Room/ Salla e Gazetarëve , qe ndodhet në katin e pare te godinës,
2. Te ambjenti i caktuar për gazetarët te Salla e Seancave Plenare.

Neni 13

Kushtet e punës

Kuvendi i Shqipërisë u siguron personave të akredituar mjediset e punës.

Neni 14

Komunikimi me masmedien

Kuvendi i Shqipërisë siguron komunikim të vazhdueshem me personat e akredituar. Ai informon personat e akredituar në kohë dhe me transparencë të plotë për veprimtarinë e Kuvendit.

Neni 15

Regjistri elektronik

1. Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun në Kuvend, krijon regjistrin elektronik për personat e akredituar.
2. Regjistri elektronik përmban:
 - a) listën e masmedieve të akredituara në Kuvendin e Shqipërisë;

- b) përfaqësuesit e tyre;
- c) kohën e akreditimit;
- d) kontakte të nevojshme.

KREU IV

ORIENTIMI I MASMEDIEVE

Neni 16

Shoqërimi

Kuvendi i Shqipërisë, kryesisht punonjësit përgjegjës për rendin dhe sigurinë, si edhe, kur shihet e nevojshme edhe përfaqësues nga zyra e shtypit, sigurojnë shoqërimin e personave të akredituar gjatë qëndrimit të tyre në Kuvend.

Neni 17

Lëvizja në mjediset e Kuvendit

1.Kuvendi i Shqipërisë siguron lëvizje të personave të akredituar duke respektuar rregullat e sigurisë të miratuara nga Byroja për hyrje-daljen në mjediset e Kuvendit.

2.Personat e akredituar lejohet të lëvizin:

- a) në ambjentet e përcaktuara të Kryesisë e Kuvendit sipas nenit 12 të kësaj Rregullore
- b) në ambjentet e caktuara për intervista dhe konferenca për shtyp të Kryesia e Kuvendit
- c) në godinën e seancave plenare të Kuvendit, në oborr dhe në galerinë e sipërme të sallës

3.Televizioni Publik Shqiptar (RTSH) dhe Agjencia Telegrafike Shqiptare (ATSH) gëzojnë status të vecantë përse i përket lëvizjes në mjediset e godinës së seancave plenare.

4. Personat e akredituar, punonjës të RTSH dhe ATSH, mund të lëvizin lirisht edhe në këto ambiente:

- a) galerinë e sipërme e sallës së Seancave Plenare;
- b) llozhat e katit të parë nga ana e jugut;
- c) brenda sallës së seancave plenare.
- d) ambjentet e caktuara në godinën e Kryesisë së Kuvendit

KREU V

TRANSPARENCA E VEPRIMTARISË SË KUVENDIT

Neni 18

Mbledhjet e komisioneve të përhershme dhe nënkomisioneve të Kuvendit

1. Mbledhjet e komisioneve të përhershme dhe nënkomisioneve të Kuvendit, si rregull, bëhen të hapura. Në këto raste, Kuvendi u jep sinjalin e transmetimit medieve të akredituara, sipas percaktimeve të bëra në Vendimin e Byrosë së Kuvendit nr. 68, datë 25.02.2021 “Protokolli i Sistemit Audio-Video”

2. Komisionet e përhershme dhe nënkomisionet, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, mund të vendosin që mbledhjet ose pjesë të tyre të bëhen të mbyllura. Kur vendoset zhvillimi i mbledhjes me dyer të mbyllura, drejtuesi i mbledhjes njofton stafin përgjegjës të Kuvendit për shkëputjen e sinjalit të transmetimit për mediet e akredituara.

Neni 19

Mbledhjet e komisioneve të posacme të Kuvendit

Rregullat procedurale të transmetimit të parashikuara për komisionet e përhershme të Kuvendit, zbatohen edhe për Komisionet e posacme.

Neni 20

Mbledhjet e komisioneve hetimore të Kuvendit

Rregullat procedurale të parashikuara për komisionet e përhershme të Kuvendit zbatohen edhe për Komisionet hetimore.

Neni 21

Mbledhjet e seancave plenare të Kuvendit

1. Seancat plenare të Kuvendit, si rregull, bëhen të hapura.
2. Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij, mund të vendos që mbledhjet ose disa pjesë të tyre të bëhen të mbyllura.
3. Kur vendoset zhvillimi i mbledhjes me dyer të mbyllura, personat e akredituar largohen nga salla me kërkesë të drejtuesit të seancës.

4. Largimi nga salla i personave te akredituar kryhet nga Shërbimi i Sigurisë në Kuvend në bashkëpunim me zyrën e shtypit

Neni 22

Mbledhjet e Byrosë së Kuvendit

1. Mbledhjet e Byrosë së Kuvendit, si rregull, bëhen të mbyllura.

Neni 23

Mbledhjet e Konferencës së Kryetarëve të Kuvendit

1. Mbledhjet e Konferencës së Kryetarëve të Kuvendit, si rregull, bëhen të mbyllura.
2. Në mbledhjet e Konferencës së Kryetarëve mbahen procesverbale të cilat bëhen publike dhe u shpërndahen përfaqësuesve të medias.

Neni 24

Mbledhjet e Këshillave të Kuvendit

Rregullat procedurale të transmetimit, të parashikuara për komisionet e përhershme të Kuvendit zbatohen edhe për Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin dhe Këshillin për Legjislacionin.

Neni 25

E drejta e transmetimit

Të drejtën e transmetimit e gëzojnë të gjitha mediet audiovizive.

Neni 26

Pasqyrimi i veprimtarisë parlamentare

Punimet e Seancave Plenare dhe Komisioneve Parlamentare që janë të hapura për publikun, transmetohen live edhe në faqen zyrtare të Kuvendit.

Neni 27

Pasqyrimi i punimeve të Seancës Plenare

Gjatë fillimit të punimeve të seancës plenare, personat e akredituar ftohen nga drejtuesi i seancës për të pasqyruar punimet.

Neni 28

Pezullimi i pasqyrimit të punimeve të Seancës Plenare

1. Pasqyrimi i punimeve të Seancës Plenare pezullohet:
 - a) kur punimet, me kërkesë të drejtuesit të seancës, ndërpriten për arsye të mungesës së rregullit;
 - b) për arsye pushimi.
2. Në këto raste, personat e akredituar, me kërkesë të drejtuesit të seancës, largohen nga salla ku zhvillohet mbledhja.
3. Në rast kundërshtimi, drejtuesi i seancës, i kërkon Shërbimit të Sigurisë në Kuvend të zbatojë urdhrin për largimin nga salla.

Neni 29

Organizimi i intervistave

1. Organizimi i intervistave me deputetë zhvillohet në bazë të kërkesës së paraqitur te Zyra e Shtypit në Kuvend, nga personat e akredituar.
2. Kërkesa përmban:
 - a) emër/mbiemër të deputetit që do të intervistohet;
 - b) çështjet konkrete për të cilat kerkohet intervista.
3. Intervista zhvillohet në datën dhe orën e caktuar nga deputeti në një nga mjediset e mëposhtme:
 - a) në zyrën e deputetit;
 - b) në zyrën e grupit parlamentar të cilit ai i përket;
 - c) në zyrën e komisionit të përhershëm parlamentar ku është anëtar.
 - d) në ambjentet e tjera të përcaktuara nga Kuvendi për intervista.

Neni 30

Organizimi i konferencave për shtyp

1. Konferencat për shtyp organizohen nga Kuvendi me kërkesë të Deputetit, në ambjentet e caktuara për këtë qëllim. Kërkesa për zhvillimin e konferencës bëhet nga deputeti te Zyra e Shtypit në Kuvend, jo më pak se dy orë nga momenti i mbajtjes së konferencës.
2. Zyra e shtypit në Kuvend, njofton medien e akredituar për orën dhe vendin e zhvillimit të konferencës për shtyp.

3. Zyra e Shtypit është përgjegjëse për ndjekjen dhe mbarrëvajtjen e konferencës.
4. Një kopje të deklaratës së mbajtur nga deputeti, zyra e shtypit ua vë në dispozicion personave të akredituar, me kërkesën e tyre.

Neni 31

Transmetimi nga Televizioni Publik Shqiptar

1. Televizioni Publik Shqiptar transmeton të plotë seancën plenare në kanalin e dedikuar “RTSH Kuvend”.
2. Transmetimi i Seancave Plenare nga RTSH Kuvend bëhet edhe në gjuhën e shenjave sipas modaliteteve të përcaktuara në marrëveshjen e lidhur dhe protokollin e miratuar nga Kuvendi, RTSH dhe Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar.
3. RTSH Kuvend transmeton edhe punimet e mbledhjeve të komisioneve parlamentare
4. RTSH Kuvendi merr sinjalin nga sistemi audio-video në Kuvend, nga faqja zyrtare web dhe nga rrjeti social facebook, faqja zyrtare e Kuvendit
5. Kërkesa për transmetim të plotë të seancave plenare bëhet pranë RTSH nga Sekretari i Përgjithshëm, pas vendimit të Konferencës së Kryetarëve, të paktën 24 orë përpara fillimit të seancës.

KREU VI

RREGULLI DHE SJELLJA E MASMEDIES NË KUVEND

Neni 32

Kodi i sjelljes

Personat e akredituar në Kuvendin e Shqipërisë, gjatë qëndrimit në Kuvend, zbatojnë Kodin e Sjelljes.

Neni 33

Mbajtja e qetësisë

Personat e akredituar pranë Kuvendit të Shqipërisë që ndjekin punimet në seancë plenare, nuk duhet të shprehin shenja miratimi ose mosmiratimi dhe janë të detyruar të respektojnë rregullat e përcaktuara nga Byroja e Kuvendit për mbajtjen e qetësisë. Në rast shkeljeje të tyre, drejtuesi i seancës, kërkon largimin e tyre nga salla.

Neni 34

Paraqitja në seancë plenare dhe organet e Kuvendit

Personat e akredituar pranë Kuvendit të Shqipërisë, gjatë zhvillimit të mbledhjeve të seancave plenare, paraqiten me veshje zyrtare dhe përdorimi i telefonave të lëvizsshëm duhet bërë pas aktivizimit të gjendjes “silent”.

Neni 35

Masa disiplinore

1. Kuvendi i Shqipërisë, në rast shkeljeje të Kodit të Sjelljes dhe rregullave të përcaktuara në këtë Rregullore, anulon në mënyrë të arsyetuar, kartën e akreditimit për personin e akredituar.
2. Njoftimi i komunikohet Shërbimit të Sigurisë në Kuvend dhe institucionit medietik përkatës.

Neni 36

Periudha e vlefshmërisë

Regullat e përcaktuara në këtë dokument janë të vlefshme përgjatë periudhes normale të zhvillimit të punimeve dhe nuk vlejnë për rastet e jashtëzakonshme ku mund të zbatohen kufizime të caktuara.

Neni 37

Shërbimi përgjegjës

Shërbimi i Marrëdhënieve me Publikun, si pjesë përbërëse e Shërbimit të Informacionit dhe Dokumentacionit është shërbimi përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Byroja

V E N D I M


Nr. 86, datë 06.07.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR AKREDITIMIN,
AKOMODIMIN DHE ORIENTIMIN E MASMEDIEVE PRANË KUVENDIT TË
SHQIPERISË**

Mbështetur në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, neni 105, pika 4, me propozim të Kryetarit të Kuvendit, Byroja e Kuvendit në mbledhjen e saj të datës 06.07.2021,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në "Rregulloren për akreditimin, akomodimin dhe orientimin e masmedieve pranë Kuvendit të Shqipërisë"(miratuar me vendimin e Byrosë nr.82 datë 02.06.2021) sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR AKREDITIMIN, AKOMODIMIN DHE ORIENTIMIN E MASMEDIEVE PRANË KUVENDIT TË SHQIPËRISË”

Në Rregulloren për akreditimin, akomodimin dhe orientimin e masmedieve pranë Kuvendit të Shqipërisë, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Neni 12, pika 1 ndryshohet dhe bëhet:

“Te Kryesia e Kuvendit në Neës Room/ Salla e Gazetarëve, që ndodhet në katin e parë të godinës si dhe në ambjentin e caktuar për ta që ndodhet në oborrin brenda territorit të Kryesisë së Kuvendit”.

2. Neni 16 ndryshohet dhe bëhet :

“Përfaqësues nga Zyra e Shtypit pranë Kuvendit, shoqëron persona e akredituar gjatë qëndrimit të tyre në Kuvend, kur është e nevojshme dhe sipas përcaktimeve të kësaj Rregullore.

3. Te Neni 17, pika 2, pas gërme b), të shtohet një pikë:

“c) në ambjentet e sallave të komisioneve për gjatë zhvillimit të mbledhjeve të komisioneve parlamentare dhe mund të jenë të pajisur edhe me aparatet e tyre celular.

4. Te Neni 18, pas pikës 1, të shtohet një pikë si më poshtë:

Pika 2 “Kuvendi siguron për mediet, marrjen e planeve me kamerat e tyre, në fillimin e mbledhjes së komisioneve parlamentare, për një periudhë kohore deri në 5 min, nga hapja e mbledhjes. Pas marrjes së planeve , operatorët shoqërohen nga punonjësit e zyrës së Shtypit për në ambjentet e përcaktuara për ta në Kryesinë e Kuvendit”.

5. Neni 29, pika 1, ndryshohet dhe bëhet :

“Organizimi i intervistave zhvillohet, pasi vihet në dijeni Zyra e Shtypit në Kuvend, nga personat e akredituar”.

6. Neni 29, pika 2 hiqet fare.

Miratuar me vendimin e Byrosë nr.86, date 06.07.2021.